



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.851/ 11 prot.

Datë 05.05.2026

V E N D I M
Nr. 588 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.529/2026, datë 22.04.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Shërbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK, me NIPT L92713601Q, Adresa:Lagjja 18 Shtatori, Rr. Xhorxh Sorros, nr. 1524, Gjirokastër.

Operatori ekonomik Operatori ekonomik ”InfoSoft Office” ShPK, me Nipt J62426002Q, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë. Adresa:Rruga 5 Maji, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin nr.529/2026 datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.*
 2. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office ” SHPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.*
 3. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Sherbim, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “Shërbime të printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.*
 4. *Autoriteti kontraktor të pasqyrojë ndryshimet dhe sqarimet me shtojcën përkatëse sipas Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij Vendimi.*
 5. *Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin brenda 5 ditëve nga publikimi i shtojcës.*
 6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për ktimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.*
 7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 1156/16 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën nr. 851/8 prot., datë 30.04.2026, autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr. 529/2026, datë 22.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën ardhur me nr. 1156/16 prot., datë 29.04.2026, protokolluar me tonën nr. 851/8 prot., datë 30.04.2026, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 529/2026, datë 22.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet:

se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcat përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimit të KSHA-së dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor *Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë*, ka zbatuar vendimin Nr.529/2026, datë 22.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, *Shërbim*, me Nr. REF-78609-03-09-2026, me objekt “*Shërbime të printimit dhe fotokopjimit*”, me fond limit 2,885,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 24.03.2026, nga autoriteti kontraktor *Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë*.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

